



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 11
Prishtinë, më 5 maj 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 5 MAJ 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 prill 2011,
4. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Xhevahire Izmaku, Xhevdet Neziraj, Florin Krasniqi, Lutfi Haziri, Anton Quni, Ramiz Lladrovci, Rita Hajzeraj, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Teuta Haxhiu dhe Halit Krasniqi, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Lutfi Haziri, parashtoi pyetje për ministrin Memli Krasniqi lidhur me veprimet e ndërmarra për rregullimin e statusit të punonjësve dhe performuesve kulturorë.

Ministri Krasniqi iu përgjigj pyetjes së deputetit Haziri.

Deputeti Lutfi Haziri, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministrin Slobodan Petroviq lidhur me themelimin e komunave të reja.

Zëvendëskryeministri Petroviq iu përgjigj pyetjes së deputetit Haziri.

Deputeti Salih Morina, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me kthimin e artefakteve nga ana e Serbisë, në kuadër të bisedimeve Kosovë-Serbi.

Zëvendëskryeministrja Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetit Morina.

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi lidhur me mjetet e qytetarëve të Kosovës të cilat janë të dedikuara për mirëmbajtjen e burgjeve, si dhe lidhur me tenderin e mishit.

Zëvendëskryeministri Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Haxhiu.

Deputetja Alma Lama, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me vlerën e kontratës së nënshkruar për ndërtimin e autostradës Vërmicë-Merdare.

Kryeministri Thaçi nuk ishte prezent në sallë.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 28 prill 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 prill 2011.

4. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë për Interpelancë të kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi lidhur me bisedimet Kosovë- Serbi.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e Interpelancës, prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar, në bazë të vendeve që kanë në Kuvend dhe për deputetët pa grup parlamentar, e cila është përcaktuar në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kryesuesi ftoi propozuesin e Interpelancës ta marrë fjalën.

Deputeti **Albin Kurti** tha se këto bisedime as nuk janë iniciuar e as projektuar në Kosovë dhe se qëllimi i tyre u ndërtua nga qëllimi i BE-së dhe Serbisë. Nëpërmjet këtyre bisedimeve Serbia fiton statusin e vendit kandidat për në BE, ndërsa Kosova fiton kopjet e dokumentacioneve të plaçkitura nga ana e Serbisë.

Deputeti Kurti më tutje vuri në pah se statusi i Kosovës nuk është një çështje abstrakte. Ai reflekton në çdo temë për të cilën po bisedohet në Bruksel dhe se me këto bisedime gjithçka do të ketë anën e vet shqiptare dhe anën e vet serbe.

Derisa Serbia nuk e njeh shtetin e Kosovës, çështja e statusit është në çdo temë dhe çdo rezultat nga këto bisedime do të jetë në disfavor të vendit tonë, vlerësoi ai.

Në vazhdim, deputeti Kurti u fokusua në debatin që është zhvilluar në Komisionin për Punë të Jashtme për të njëjtën temë me zëvendëskryeministren, Edita Tahiri, si dhe përgjigjet që kjo e fundit ka dhënë para anëtarëve të këtij komisioni.

Në fund, ai parashtoi këto pyetje për kryeministrin:

- A e njeh Republika e Kosovës Republikën e Serbisë?
- Çka keni biseduar me këshilltarin e Ketrin Ashton – Robert Kuper?
- Pse Qeveria e Kosovës nuk e zbaton masën e reciprocitetit në raport me Serbinë?
- A ekzistojnë procesverbalet dhe transkriptet nga bisedimet e Brukselit dhe kur do t’ua dërgoni ato deputetëve të Kuvendit?
- A i keni në formë të shkruar pozicionet e znj. Edita Tahiri në këto bisedime?
- A ekziston një platformë e Qeverisë së Kosovës përmes së cilës do të udhëhiqej në këto bisedime znj. Edita Tahiri? dhe
- A do t’i pranoni kopjet e regjistrave civilë të Kosovës, të plaçkitur nga Serbia?

Kryeministri **Hashim Thaçi**, tha se dialogu teknik Kosovë – Serbi, i filluar në mars të këtij viti, paraqet mundësi të mirë për zgjidhjen e çështjeve teknike. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës kemi hyrë në këto bisedime me platformë të qartë, me besimin se duke qenë partner serioz të SHBA-ve dhe të BE-së, do t’ia dalim ta shtrijmë pushtetin në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, kryeministri Thaçi duke vlerësuar lartë rolin e partnerëve tanë, SHBA-së, NATO-s dhe BE-së, në funksion të sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve të Kosovës, tha se dhe çdo qasje tjetër paraqet tentim për kthim mbrapa dhe kjo është në kundërshtim me qasjen si të pozitës, ashtu edhe të pjesës më të madhe të opozitës në Kosovë.

Arsye tjetër pse kemi pranuar dialogun me Serbinë, është e dhëna se refuzimi ndaj Serbisë nuk bëhet me ngritje të zërit në Kuvend, por me punë dhe angazhim konkret, gjë që ka rezultuar me lirinë e Kosovës, theksoi ai.

Më tej, kryeministri tha se dialogun e shohim edhe si obligim ndërkombëtar pas opinionit të GjND-së, me çka u dëshmuar edhe një herë se pavarësia e vendit tonë nuk bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare, por njëkohësisht dialogun e shohim edhe si obligim ndërkombëtar për fuqizim institucional dhe progresin e arritur në Kosovë.

Në fund, kryeministri tha se si Qeveri e Republikës së Kosovës kemi vendosur edhe vijat e kuqe, për të cilat nuk do të ketë asnjëherë dialog, të cilat janë:

- Statusi i Kosovës është i zgjidhur,

- Integriteti territorial i pacenueshëm, dhe
- Rregullimi i brendshëm është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Planin e Presidentit Ahtisari.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Interpelancën e kryeministrit Hashim Thaçi.

Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar obligimin ndërkombëtar për të hyrë në dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë konform Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të datës 9 shtator 2010, dhe në përputhje me kompetencat kushtetuese të Qeverisë për të ushtruar sovranitetin shtetëror me politikën e jashtme të vendit.

Ai paraqiti qëndrimet e grupit parlamentar të PDK-së lidhur me këtë çështje, duke shtuar se mbështesin Kryeministrin z. Hashim Thaçi, i cili është duke e respektuar vullnetin e qytetarëve të vendit dhe duke përmbushur obligimet kushtetuese që çështjet e hapura me Serbinë do t'i mbyllë në këtë mandat dhe Kosovës do t'i hapë rrugë për në Bashkimin Evropian.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, tha se fillimi i dialogut pa platformë të qartë, pa një qëllim të qartë, me bisedime pa transparencë, me agjendë thuaja se ad-hoc, janë disa nga çështjet që vazhdojnë të na shqetësojnë dhe të na bëjnë të besojmë se rezultate pozitive për Kosovën nga bisedimet e tilla nuk ka dhe nuk do të ketë.

Grupi parlamentar i LDK-së edhe një herë përsërit qëndrimin e saj se për zhvillimin e bisedimeve duhet pasur platformë të qartë, ambient të përshtatshëm, definim të saktë se çka mund dhe çka nuk mund të bisedohet, çka dëshirohet të arrihet me këto bisedime, me përfaqësim të njëjtë nivelesh, me rolin e pazëvendësueshëm të Kuvendit në këto bisedime, me kyçjen e drejtpërdrejtë dhe me rolin edhe më të madh që duhet ta luajnë SHBA-të në këtë proces, së bashku me vendet e BE-së. Vetëm nëse zhvillohen si të tilla, mund të ketë optimizëm për ndonjë rol pozitiv.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se Qeveria ka qenë krejtësisht e mbyllur për qytetarët e Kosovës deri tash lidhur me këto negociata. Në emër të besueshmërisë, është shkelur transparenca. Por, për aq sa dimë, e kemi informata, këto janë negociata që kanë filluar tash e dy muaj, e kanë dëmtuar Republikën e Kosovës në disa aspekte. Edhe pse Qeveria negociatat po i quan teknike, ato po prekin drejtpërdrejt shtetësinë e Republikës së Kosovës. Problemi kryesor në mes Kosovës dhe Serbisë nuk është mungesa e komunikimit e as e negociatave, siç po arsyeton edhe EULEX-i, edhe Qeveria. Problemi kryesor në mes Kosovës dhe Serbisë është hegjemonia e Serbisë dhe dorëzimi i Qeverisë të Kosovës përpara këtij agresioni të Serbisë.

Kompromisi i parë në negociatat tashmë kanë ndodhur. Qeveria i ka pranuar kopjet e regjistrave civilë, duke u pajtuar që origjinalin ta mbajë Serbia. Qeveria e Kosovës, me veprimet e saja të papërgjegjshme po e dëmton edhe procesin e njohjeve të shtetit të Kosovës.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se zgjidhja e kontesteve në mes shteteve mund të bëhet me negociata dhe bisedime e jo me dhunë. Ato në esencë janë mjet legjitim i punës të qeverive të cilat nuk synojnë dhunë. Bisedimet janë një mjet pune për të arritur deri te një rezultat kur negociohet, kur kërkohet diçka prej Serbisë, e ne ende nuk po dimë se çka po kërkon Serbia prej nesh në këto të ashtuquajtura bisedime. Por, problemet e Kosovës rrjedhin fillimisht nga paaftësia e Qeverisë së Kosovës për t' i shërbyer vendit.

Për zhvillimin e këtyre bisedimeve ka qenë dashur të kemi ndërtuar një minimum të konsensusit të brendshëm për një Platformë që përmban vijat e kuqe se çka mund dhe çka nuk mund të bisedohet.

Kosova, në këto bisedimi që i ka filluar, nuk po fiton jo për shkak se ato janë të këqija, por për shkak se Qeveria jonë nuk është përgatitur për zhvillimin e tyre.

Amir Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se këto bisedime duhet të kenë për qëllim realitetin, duke mos e harruar të kaluarën, por të kthehemi kah e ardhmja, të vazhdojmë rrugën për përpjekjet tona për integrimin e vendit tonë, duke i treguar bashkësisë ndërkombëtare se Kosova është një partner konstruktiv në rrugën e shtet ndërtimit.

Qëllimi i mirë i Kosovës për bisedime, për çështje jetike të qytetarëve nuk mund të keqpërdoret nga pala serbe dhe nuk duhet të lejojmë të ndodhë ajo.

Respektimi i reciprocitetit në të gjitha fushat, ka qenë një prej kërkesave tona për bisedime dhe ajo duhet të jetë e tillë në vazhdimësi. Nëse dëshirojmë që bisedimet të mos i sjellin favore vetëm Serbisë, por edhe Kosovës e po ashtu edhe bashkëkombësve tanë në Luginën e Preshevës.

Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se mbështesin procesin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, për të cilin edhe kanë votuar Rezolutën e Kuvendit, të miratuar kohë më parë lidhur me këto bisedime. E mbështesim këtë dialog për shkak se presim që rezultatet e tij do të shpijnë në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve dhe do të lehtësojnë jetën e tyre të përditshme, pa dallim etnie.

Ky grup nuk është edhe aq i kënaqur me transparencën e zhvillimit të këtyre bisedimeve, por nëse kjo formë e punës kontribuon më mirë në zgjidhjen e problemeve dhe jep rezultate konkrete, nuk kanë asgjë kundër kësaj forme.

Këto bisedime nuk duhet kuptuar si bisedime për territor, po bisedime për zgjidhjen e probleme praktike të qytetarëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë çështje dhanë edhe këta deputetë: **Alma Lama, Sabri Hamiti, Blerim Shala, Florin Krasniqi, Shaip Muja, Daut Haradinaj, Arben Gashi, Lutfi Haziri, Donika Kadaj-Bujupi, Hashim Deshishku, Arsim Bajrami, Skënder Hyseni, Agim Kuleta, Ahmet Isufi dhe Muhamet Mustafa.** Diskutimet e plota të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve janë dhënë në Transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në përfundim të këtyre diskutimeve, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi dha sqarime dhe paraqiti qëndrimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me bisedimet teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në fund, në emër të propozuesit të Interpelancës, deputeti Albin Kurti paraqiti tekstin e Mocionit, i përbërë prej tri pikave, për miratim.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, te tri propozimet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Pas votimit të propozimeve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, për secilën pikë veç e veç, kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicë votash

V E N D O S I

1. Kuvendi nuk e miratoi propozimin për ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë,
2. Kuvendi miratoi propozimin që Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë hapa konkretë për të shtrirë autoritetin e shtetit të Kosovës në gjithë territorin e saj, veçanërisht në veri,
3. Kuvendi miratoi propozimin që Qeveria e Republikës së Kosovës ta informojë rregullisht, çdo tre (3) muaj, Kuvendin e Republikës së Kosovës për përpjekjet e saj për të vendosur kontroll në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010

Deputeti **Idriz Vehapi**, në emër të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Raportin vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar Miletqi, si dhe deputetët: Fadil Demaku, Ali Sadriu, Teuta Haxhiu, Naser Osmani, Donika Kadaj-Bujupi, Blerta Deliu dhe Berat Buzhala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 43,
Kundër----- 38,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 17:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale